



		<b>E KOSOVËS NË ULLËTJA KOSOVAR REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dat.	Dat.	Dat.	Dat.
Nr. fajq.	Dok.	Nr. Prot.	Datum
Broj stranica	03	Br. Prot.	28.04.2020
Nr. papirs		Prot. Nr.	

**Republika e Kosovës**



Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

\* REPUBLIK  
AGJENCIJA

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 23.04.2020, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Mylllet rasti me nr. AKK-DPKI-06/3012/19, për zyrtarin e lartë z. Burim Geci, Drejtor i Operativës, Posta e Kosovës sh.a., Prishtinë, për shkak së është shhangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

I. Agjencia kundër Korruptionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia) ka shqyrtuar rastin për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPKI-06-3012/19*, lidhur me zyrtarin e lartë z. Burim Geci, Drejtor i Operativës, Posta e Kosovës sh.a., Prishtinë, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Burim Geci, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Drejtor i Operativës, Posta e Kosovës sh.a., Prishtinë, i njëjtë ushtronc funksionin e Kryetarit dhe Përfaqësuesit të Autorizuar në Organizatën jo-qeveritare “Akademia e Karatesë Tradicionale e Kosovës”. Përmes shkresës zyrtare, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ, Ministria e Administratës Publike, verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni dhe nga përgjigja zyrtare (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-2632-1/19), rezulton se zyrtari i lartë z. Burim Geci është themelues dhe person i autorizuar në OJQ-në në fjalë.

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Burim Geci për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-3012/19, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.



Pas pranimit të kësaj shkrese, me kërkesë të zyrtarit të lartë, Agjencia ka organizuar dhe mbajtur një takim brenda ambienteve të saj, ku i njëjti është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj funksion drejtues as të jetë Përfaqësues i Autorizuar në OJQ, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku thuhet se:

*"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkates për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit".*

Si dhe nenin 14 paragrafi 1, i cili përcakton se:

*"Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përvëç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to".*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të faktave, zyrtari i lartë z. Burim Geci është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëherëshme dhc konkrete në mënyrë që të shhang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin (shkresa zyrtare DPKI-06/857/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Burim Geci ka dhënë dorëheqje nga funksioni drejtues në Organizatën jo-qeveritare "Akademia e Karatesë Tradicionale e Kosovës" si dhe i njëjti nuk figuron më të jetë as Person i Autorizuar në OJQ-në në fjalë.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Burim Geci, Drejtor i Operativës, Posta e Kosovës sh.a., Prishtinë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shhangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollı,  
Drejtore i Agjencisë kundër Korruptionit

